REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës:	2018:051633
Datë:	28.06.2019
Numri i dokumentit:	00382380

P.nr. 636/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit, B A, për shkak të veprës penale te rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 te KPRK-së, e sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/II.nr. 1273/18, të dt. 14.09.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të dt. 19.06.2019, në prezencë të Prokurorit të shtetit Suada Hamza, të pandehurit B A, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.28.06.2019, përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I pandehuri

B A, i biri i Bashkimit dhe nënës L, e gjinisë Q, i lindur me dt. ..., në fsh. C K- Istog ku edhe banon, identifikohet në bazë të lnj.nr. personal ..., ka të kryer pese klasë te shkollës fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. tel. ..., egjiptian, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me dt. 15.06.2018, rreth orës 17:30 min, në, ne rrugën R- Pejë, pikërisht ne fshatin N K- Pejë, ne afërsi te qendrës se fshatit nga pakujdesia shkel nenin 50, 53, 69 par.2 dhe 128 te ligjit me nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, rrezikon jetën e njerëzve, pasurinë duke i shkaktuar lëndime te renda trupore personit tjetër dhe te dëmtuarës – te miturës A. E. nga fsh. R- K- Pejë, ne atë mënyrë qe pasi qe i pandehuri derisa po drejtonte motoçikletën e markës G C/27, ngjyre te kaltër pa targa, ne vendin e lartcekur ku shpejtësia e lëvizjes është e kufizuar ne 50 km/h , ne

2018:053912

drejtimin Pejë- Prishtinë, nuk përshtat shpejtësinë e lëvizjes ne raport me kushtet dhe rrethanat e rrugës, si dhe nuk mban distancën e duhur anësore ne mes te tij dhe biçikletës anash tij dhe kështu e godet te njëjtën dhe shkakton aksident komunikacioni.

-me çka ka kryer vepër penale te rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 te KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 41, 42, 43, 45, 47, 73, 74, 75 par.1, nën par. 1.3, neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 te KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin e:

GJ Y K O N

- Dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e i cili dënim konform nenin 47 të KPRK-së, me pëlqimin e te pandehurit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 1200 (njëmijë e dyqind) euro, te cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

- I pandehuri lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore

- E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr. 1273/2018, të dt. 14.09.2018, ndaj të pandehurit B A, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 te KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 19.06.2019, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe bazuar ne dispozitën e nenit 244 të KPP-së, është konstatuar se prokurori i shtetit, ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave.

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaron se e ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës nuk kanë nevojë.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit qe të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

2018:053912

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, pa presion nga askush.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi qe të pandehurit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: procesverbali mbi vend shiqim e aksidentit te dt. 09.07.2018, si dhe përshkrimi i vendit te ngjarjes e dt. 15.06.2018, deklarata e te pandehurit B A e dhënë ne polici me dt. 15.06.2018, raporti mjekësor i Spitalit regjional te Pejës me dt. 15.06.2018 me nr. te protokollit 11238, fletë lëshimi me epi krizë nga QKUK-Prishtine e dt. 19.06.2018, me nr. te amzës 193/2018, fletë lëshimi me epi krizë nga QKUK-Prishtinë e dt. 21.06.2018, me nr. te amzës 4759, foto dokumentacioni, akt ekspertimi i mjeko-ligjor me nr. te ref, PE-643/2018 i dt. 15.08.2018, ekspertiza e komunikacionit e dt. 15.08.2018, deklarata e te pandehurit B A e dhënë ne prokurori me dt. 11.09.2018, deklarata e përfaqësuesit ligjor- prindit te dëmtuarës- et miturës, Blerim Elezaj e dhënë ne prokurori me dt. 13.09.2018 si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit B A, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale te rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 te KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurin dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, sinqeritetin deklarues, shprehjen e keqardhjes për veprën e kryer, gjendjen e dobët ekonomike, se me pare nuk ka qene i dënuar dhe ndaj te njëjtit nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të

2018:053912

pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për lirimin nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par.4, të KPP-së, meqë i pandehuri jeton ne kushte te renda ekonomike.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.636/18 dt. 28.06.2019

Bashkëpunëtorja profesionale
Selvane Bukleta

G J Y Q T A R I
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita
e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
e nëpërmjet të kësaj gjykate.

2018:053912